



Legal Alert Albania



August 2024



pwc



Law No. 52/2024 “On the Labeling of Energy-Impacting Products”

This law establishes obligations for products that impact energy, placed on the market or in service. These obligations include energy labeling of products; provision of standard information on energy efficiency; energy consumption and other resources during use; supplementary product information. The purpose is to enable end-users (purchasers) to choose products based on their energy performance, aiming to reduce energy consumption.

This law applies to:

- Products that have a significant, direct, or indirect impact on energy consumption during use and, where applicable, on other primary resources.

This law does not apply to:

- Used products, except when imported;
- Any means of transport for persons or goods.

Imported used products must be equipped with the labels and information required by this law. The placing on the market or the putting into service of products that comply with the requirements of this law and its implementing bylaws shall not be prohibited, restricted, or impeded.

General obligations regarding information requirements:

1. It is prohibited to place or display labels, brands, symbols, or other inscriptions that do not comply with the requirements of this law and its implementing bylaws, which may cause confusion or mislead the end-user regarding the energy consumption of products with an impact on energy or, where applicable, on other primary resources during use.
2. Suppliers and traders are required to:
 - a. Refer to the energy efficiency class of the product and the range of energy classes available on the label, in visual advertisements or promotional technical sheets, for a specific model, in accordance with this law and relevant implementing bylaws;
 - b. Cooperate with the responsible market surveillance authority and take immediate measures to rectify any non-compliance with the requirements set out in this law and relevant implementing bylaws, under their responsibility, on their initiative, or when requested to do so by the market surveillance authorities;



Ligj Nr. 52/2024 “Për Etiketimin e Produkteve me Ndikim në Energji”

Ky ligj përcakton detyrimet për produktet që ndikojnë në energji, të vendosura në treg ose në shërbim. Këto detyrime përfshijnë: etiketimin energjetik të produkteve; dhënien e informacionit standard mbi eficiencën e energjisë; konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera gjatë përdorimit; si dhe informacion plotësues për produktin. Qëllimi është të mundësohet që përdoruesit fundorë (blerësit) të zgjedhin produkte bazuar në performancën e tyre energjetike, duke synuar reduktimin e konsumit të energjisë.

Ky ligj zbatohet për:

- Produkte që gjatë përdorimit kanë një ndikim të rëndësishëm, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për konsumin e energjisë dhe, sipas rastit, për burimet e tjera kryesore.

Ky ligj nuk zbatohet për:

- Produktet e përdorura, përveçse kur importohen;
- Cdo mjet transporti për persona ose mallra.

Produktet e përdorura që importohen duhet të jenë të pajisura me etiketat dhe informacionin e kërkuar sipas këtij ligji. Nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet vendosja në treg a vënia në shërbim e produkteve, të cilat mbulohen dhe janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Detyrime të përgjithshme mbi kërkesat për informacion:

1. Ndalohet vendosja apo shfaqja e etiketave, markave, simboleve apo mbishkrimeve të tjera që nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, të cilat mund të shkaktojnë konfuzion ose të çorientojnë përdoruesin fundor lidhur me konsumimin e energjisë së produkteve me ndikim në energji ose, sipas rastit, të burimeve të tjera kryesore gjatë përdorimit.
2. Furnizuesit dhe tregtarët janë të detyruar:
 - a. T'i referohen klasit të eficiencës së energjisë së produktit dhe gamës së klasave energjetike të disponueshme në etiketë, në reklamat vizuale ose në skedat teknike promovuese, për një model specifik, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore përkatëse;
 - b. Të bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës të mbikëqyrjes së tregut dhe të marrin masa të menjëhershme për të korrigjuar çdo rast mospërputhjeje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore, që bien nën përgjegjësinë e tyre, me nismën e tyre ose kur kërkohet ta bëjnë këtë nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut



c) For products not covered by the implementing bylaws of this law, as well as for products that do not impact energy, they must not supply or display labels that imitate the labels provided for in this law and relevant implementing bylaws. This does not include labels provided for in national legislation, except where such labels are provided for in the relevant implementing bylaws, under this law

3. Incentive schemes for the purchase of specified products in the legal and sub-legal acts subsidized by the state budget will be implemented, targeting the two highest available energy efficiency classes or the highest classes as specified in the sub-legal acts for specific products. The law clarifies, among other things, that information is provided particularly through labeling, the product sheet, and supplementary information, enabling the end-user to choose the most efficient products. The information must be in Albanian, accurate, and understandable. Products, details for the label and the product sheet, including the procedure for verifying the conformity of each type of energy-impacting product, are determined by a decision of the Council of Ministers. For specific products, the relevant implementing act may include detailed requirements, aimed at regulating the labeling process or their registration in a public register, covering every possible technical aspect.

c) Që për produktet që nuk mbulohe nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, si dhe për produktet që nuk kanë ndikim në energji, të mos furnizojnë ose të shfaqin etiketa që imitojnë etiketat e parashikuara në këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore. Këtu nuk përfshihen etiketat e parashikuara në legjislacionin kombëtar, përveç rasteve kur ato etiketa parashikohen në aktet nënligjore përkatëse, sipas këtij ligji.

3. Skemat për nxitjen e blerjeve të produkteve të specifikuar në aktet ligjore dhe nënligjore me subvencionim nga buxheti i shtetit do të realizohen duke synuar dy klasat më të larta të eficiencës së energjisë, të disponueshme gjerësisht ose klasat më të larta, siç përcaktohet në aktet nënligjore për produkte specifike. Ligji sqaron ndër të tjera se informacioni sigurohet veçanërisht nëpërmjet etiketimit, skedës informative dhe informacionit plotësues, duke i mundësuar përdoruesit fundor zgjedhjen e produkteve më eficiente. Informacioni duhet të jetë në gjuhën shqipe, i saktë dhe i kuptueshëm. Produktet, hollësitë për etiketën dhe skedën informative, përfshirë edhe procedurën për verifikimin e konformitetit për çdo tip produkti me ndikim në energji përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për produkte specifike, akti nënligjor përkatës mund të përmbajë kërkesa të detajuara, që synojnë të rregullojnë procesin e etiketimit apo regjistrimit të tyre në regjistrë publik, duke mbuluar çdo aspekt të mundshëm teknik.

Obligations of suppliers:

- Suppliers who place on the market or put into service products under the requirements of this law must ensure that the label and the product sheet comply with the requirements of this law and the relevant implementing bylaw under this law.
- The supplier prepares the technical documentation, which must be sufficient to enable the assessment of the accuracy of the information contained in the label and product sheet.
- Once the last unit of a model has been placed on the market, the supplier retains information about that model for a 15-year period. Where appropriate, in relation to the average lifespan of a product, a shorter retention period may be provided by the relevant implementing acts.
- Suppliers must make the technical documentation available to the responsible market surveillance authority, in electronic or physical form, within 10 working days after receiving the request from this authority.
- Suppliers must provide the necessary labels and product information free of charge, upon request from traders.

Detyrimet e furnizuesve:

- Furnizuesit, që vendosin në treg ose vënë në shërbim produkte sipas kërkesave të këtij ligji, sigurojnë etiketën dhe skedën informative në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me aktin nënligjor përkatës në zbatim të këtij ligji
- Furnizuesi përgatit dokumentacionin teknik, që duhet të jetë i mjaftueshëm për të mundësuar vlerësimin e saktësisë së informacionit, që përmban etiketa dhe skeda informative.
- Pasi njësia e fundit e një modeli të jetë hedhur në treg, furnizuesi ruan informacionin në lidhje me atë model për një periudhë 15-vjeçare. Aty ku është e përshtatshme, në lidhje me jetëgjatësinë mesatare të një produkti, një periudhë më e shkurtër ruajtjeje mund të parashikohet nga aktet nënligjore përkatëse.
- Furnizuesit vënë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut dokumentacionin teknik, në formë elektronike ose fizike, brenda 10 ditëve pune, pas marrjes së kërkesës nga kjo strukturë.
- Furnizuesit sigurojnë falas etiketat e nevojshme dhe informacionin për produktin, sipas kërkesës së tregtarëve.



- Regardless of the system chosen by the supplier for label distribution, the supplier must distribute the labels immediately and in any case within five working days upon request from traders.
- In addition to labels, the supplier must also provide the product sheet.
- The supplier includes a product sheet in all product brochures. If the supplier does not provide product brochures, they must provide product sheets along with other explanatory materials that accompany the product.
- The supplier is responsible for the accuracy of the labels and product sheets they distribute.
- The publication of the information provided on the label or in the product sheet, any advertising for the respective energy-impacting product, and any promotional technical material, as referred to in paragraphs 4 and 5 of Article 6 of this law, is considered approved by the supplier.
- Once a unit of a model is in service, the supplier must, in any case, seek the client's consent regarding any changes intended to be included in the unit through updates, which would be detrimental to the energy efficiency parameters of that unit, as specified in the relevant implementing act.
- The supplier informs the client about the purpose of the update and the changes in parameters, including any change in the label class.
- For a period proportional to the average lifespan of the product, the supplier has the obligation to give the client the option to refuse the update, avoiding the loss of functionality.
- The supplier will not place on the market products that are designed in such a way that the performance of a model is automatically altered under test conditions, aiming to achieve a more favorable level for any of the parameters specified in the relevant implementing act or included in the documentation accompanying the product.

Obligations of traders

- Traders must visibly and legibly display the labels and ensure that the product sheet is included in the product brochure or any other explanatory material accompanying the product when sold to the end-user, including remote sales over the internet.
- When a product covered by an implementing act is displayed, in accordance with this law, the trader must attach the appropriate label in Albanian and in a clearly visible position, as specified in the relevant implementing act.

- Pavarësisht sistemit të zgjedhur nga furnizuesi për shpërndarjen e etiketave, furnizuesi i shpërndan menjëherë etiketat dhe në çdo rast brenda pesë ditëve pune me kërkesë të tregtarëve.
- Përveç etiketave, furnizuesi siguron dhe skedën informative të produktit.
- Furnizuesi përfshin një skedë informative në të gjitha broshurat e produktit. Kur furnizuesi nuk siguron broshura të produktit, ai siguron skeda informative së bashku me materiale të tjera shpjeguese që shoqërojnë produktin.
- Furnizuesi është përgjegjës për saktësinë e etiketave dhe skedave informative që ai shpërndan.
- Publikimi i informacionit të dhënë në etiketë ose në skedën informative, çdo publicitet për produktin përkatës me ndikim në energji, si dhe çdo material teknik promovues, referuar përkatësisht në pikat 4 dhe 5 të nenit 6 të këtij ligji, konsiderohet i miratuar nga furnizuesi.
- Pasi një njësi e një modeli të jetë në shërbim, furnizuesi kërkon në çdo rast pëlqimin nga klienti në lidhje me çdo ndryshim që synohet të përfshihet në njësi me anë të përditësimeve, të cilat do të ishin të dëmshme për parametrat e eficientësisë së energjisë për atë njësi, siç përcaktohet në aktin përkatës nënligjor.
- Furnizuesi informon klientin për objektivin e përditësimit dhe për ndryshimet në parametra, duke përfshirë çdo ndryshim në klasën e etiketës.
- Për një periudhë proporcionale me jetëgjatësinë mesatare të produktit, furnizuesi ka detyrimin t'i japë klientit mundësinë e refuzimit të përditësimit, duke shmangur humbjen e funksionalitetit;
- Furnizuesi nuk do të vendosë në treg produkte që janë projektuar, në mënyrë të tillë që performanca e një modeli të ndryshohet automatikisht në kushtet e testimit, me qëllim arritjen e një niveli më të favorshëm për cilindo nga parametrat e specifikuar në aktin përkatës nënligjor ose të përfshirë në dokumentacionin që shoqëron produktin.

Detyrimet e tregtarëve

- Tregtarët paraqesin në mënyrë të dukshme e të lexueshme etiketat dhe mundësojnë që skeda informative të jetë përfshirë në broshurën e produktit ose në çdo material tjetër shpjegues që shoqëron produktin kur shitet te përdoruesi fundor, duke përfshirë dhe shitjen në distancë në internet.
- Kur ekspozohet një produkt i mbuluar nga një akt nënligjor, në zbatim të këtij ligji, tregtari bashkëngjit etiketën e përshtatshme në gjuhën shqipe dhe në një pozicion qartësisht të dukshëm, siç specifikohet në aktin nënligjor përkatës.



Sanctions:

The law also provides for administrative sanctions for non-compliance, imposing fines ranging from 150,000 ALL to 300,000 ALL.

Administrative appeal against the decision for the administrative violation is submitted and reviewed according to the provisions of the Code of Administrative Procedures.

The decision on the administrative offense constitutes an executive title and is enforced by the bailiff service if not paid on time by the natural or legal person who committed the offense and if the right to appeal has not been exercised within the time limits provided by the Code of Administrative Procedures.

Conclusion and Further Reading

This summary highlights the critical aspects of Law No. 52/2024, which aims to enhance energy efficiency through better-informed consumer choices. Stakeholders are encouraged to familiarize themselves with the full text of the law to ensure complete compliance and to take advantage of the opportunities it presents for promoting energy-efficient products.

Please note that this overview is not exhaustive and is intended to provide guidance on the key points of Law No. 52/2024. For a comprehensive understanding, stakeholders should consult the complete text of the legislation.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([Link](#))



Instruction No. 2, dated 28.5.2024, "On the Criteria and Deadlines for Financial Support of Projects in the Tourism Sector"

This instruction is intended to establish the criteria and deadlines for obtaining financial support for projects and activities in the tourism sector.

To be eligible for financial support, proposals in the field of tourism must:

- Comply with the principles of sustainable tourism development in the country and the policies of the ministry for the development of the tourism industry;
- Promote the tourism industry to foster economic development and enhance the quality of life;
- Promote tourism products and destinations, as well as the values of the country's natural and cultural heritage, in accordance with the tourism event calendar;
- Encourage the professional education of human resources in entities operating within the tourism sector, with the objective of improving service quality;

Sanksionet:

Ligji gjithashtu parashikon sanksione administrative për moszbatim, duke vendosur gjoba që variojnë nga 150,000 ALL deri në 300,000 ALL.

Ankimi administrativ kundër vendimit për shkeljen administrative paraqitet dhe shqyrtohet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Vendimi për kundërvajtjen administrative përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga shërbimi përbarimor në rast se nuk shlyhet në kohë nga personi fizik ose juridik që ka kryer shkeljen dhe kur e drejta për ankim nuk është ushtruar brenda afateve kohore të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Përfundimi dhe Leximi i Mëtejshëm

Kjo përmbledhje thekson aspektet kritike të Ligjit Nr. 52/2024, i cili synon të përmirësojë efikasitetin energjetik përmes zgjedhjeve më të informuara të konsumatorëve. Palët e interesuara inkurajohen të njihen me tekstin e plotë të ligjit për të siguruar përputhshmërinë e plotë dhe për të përfituar nga mundësitë që ai ofron për promovimin e produkteve me efikasitet të lartë energjetik.

Lutemi të keni parasysh që kjo përmbledhje nuk është e plotë dhe synon të ofrojë udhëzime mbi pikat kyçe të Ligjit Nr. 52/2024. Për një kuptim të plotë, palët e interesuara duhet të konsultojnë tekstin e plotë të legjislacionit.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([Link](#))



Udhëzim Nr. 2, datë 28.5.2024 "Mbi kriteret dhe afatet për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit"

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë kriteret dhe afatet për përfitimin e mbështetjes financiare për projekte dhe veprimtari në sektorin e turizmit.

Për përfitimin e mbështetjes financiare kërkesë propozimet në fushën e turizmit duhet që:

- Të jenë në përputhje me parimet e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vend dhe politikat e ministrisë për zhvillimin e industrisë së turizmit;
- Të promovojnë industrinë e turizmit për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës;
- Të promovojnë produktet dhe destinacionet turistike, vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit në përputhje me kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse;
- Të nxisin edukimin profesional të burimeve njerëzore të subjekteve që zhvillojnë veprimtari në fushën e turizmit, në funksion të rritjes së cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit;

- Facilitate the digitalization of the tourism industry to enhance the efficiency of efforts aimed at developing innovative products and services;
- Improve the framework for studies or models of tourism products.

Entities (whether natural or legal persons, domestic or foreign) eligible for financial support for projects in the tourism sector must:

- Be registered in accordance with applicable legislation;
- Possess relevant experience in the fields of culture, tourism, entertainment, or promotion;
- Have no outstanding enforceable obligations;
- Have no final criminal convictions;
- Have fulfilled their tax obligations in accordance with Albanian legislation or applicable provisions in their country of origin;
- Have fulfilled their obligations for the payment of social contributions in accordance with Albanian legislation or applicable provisions in their country of origin.

Deadlines and procedures:

- Proposal submissions may be made at any time during the fiscal year.
- The Ministry/National Tourism Agency will make public on the official website of the proposing institution and/or in the Official Notices Bulletin the call for applications, the criteria, and the deadlines that entities must meet to obtain financial support, while specific projects may require collaboration with specialized entities.
- The implementation and approval of projects will be carried out through a process involving the responsible structure and the approval of the Minister in charge. The list of approved projects will be published on the official websites of the Ministry responsible for tourism/the National Tourism Agency, and will be followed by the signing of contracts with the successful entities.
- The monitoring of contract implementation and the execution of activities will be conducted by representatives of the Ministry of Tourism and Environment/the National Tourism Agency and/or the regional directorates of the National Agency for Protected Areas.
- Payments from the budget fund will be made as follows: 60% of the total amount at least 5 days before the start of the project, and 40% upon completion of the project, subject to the submission of documentation verifying the execution and expenses incurred in connection with the project.
- Financial support will be provided upon the submission of a letter to the Finance Directorate, accompanied by all financial and promotional materials related to the activity.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([link](#))

- Të ndikojnë në digjitalizimin e industrisë së turizmit për të rritur efikasitetin e përpjekjeve për zhvillim të produkteve dhe shërbimeve inovative;
- Të përmirësojnë kornizën e studimeve apo të modeleve të produkteve turistike;


Subjektet (persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj) për Përfitim të Mbështetjes Financiare të projekteve në fushën e turizmit duhet të:

- Të jenë të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të kenë eksperiencë të ngjashme në fushën e kulturës, turizmit, argëtimit, promovimit;
- Të mos kenë detyrime përbarimore;
- Të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
- Të kenë përmbushur detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
- Të kenë përmbushur detyrimet për pagimin e kontributeve shoqërore në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

Afatet dhe procedurat:

- Paraqitja e kërkesë-propozimeve mund të bëhet në çdo kohë gjatë vitit buxhetor.
- Ministria/Agjencia Kombëtare e Turizmit bën publike në faqen zyrtare të institucionit propozues dhe/ose në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, thirrjen për aplikim, kriteret dhe afatet që duhet të plotësojnë subjektet për të përfutur mbështetjen financiare, ndërsa projekte specifike kërkojnë bashkëpunim me subjekte të specializuara.
- Zbatimi dhe miratimi i projekteve kalon përmes një procesi të strukturës përgjegjëse dhe miratimit nga Ministri përgjegjës, ndërsa lista e projekteve fituese publikohet në faqet zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për turizmin/ Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe vijohet me nënshkrimin e kontratave me subjektet fituese.
- Monitorimi i zbatimit të kontratave dhe realizimit të aktiviteteve kryhet nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/ Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe/ apo drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Pagesat e përfutura nga fondi buxhetor do të kryhen 60% e vlerës, të paktën 5 ditë përpara fillimit të projektit dhe 40% e vlerës në përfundim të projektit, kundrejt dokumenteve që vërtetojnë zhvillimin dhe shpenzimet e kryera në shërbim të projektit.
- Përfitimi financiar realizohet pasi të depozitohet shkresa drejtuar Drejtorisë së Financës, me të gjitha materialet financiare dhe promovuese të aktivitetit.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë ([link](#))



Decision No. 33, Dated June 5, 2024: "On Amendments and Additions to the Regulation 'On the Licensing and Operation of Non-Bank Financial Institutions'"



Vendim Nr.33, datë 5.6.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka"

The main amendments consist of:


- Amendment of the regulation's title as follows: "On the licensing, operation, revocation of the license, and liquidation of the credit portfolio created by the exercise of financial activities by non-bank financial entities."
- Addition to the scope of the regulation: "the revocation of the license of non-bank financial entities to engage in financial activities in the Republic of Albania" and "the liquidation of the credit portfolio created by the exercise of financial activities under the license of the non-bank financial entity."
- Inclusion of Law no. 9901 dated 14.4.2008, "On traders and commercial companies," as amended, and Law no. 110/2016, dated 27.10.2016, "On bankruptcy", as the legal basis for this regulation.
- Definition within the regulation of the concept of "liquidation of the credit portfolio created by the exercise of financial activities under the license," explaining it as "the process of administering the credit portfolio of the non-bank financial entity, created by the non-bank financial entity as a result of the financial activity exercised under the license granted by the Bank of Albania (hereinafter referred to as 'liquidation')."
- Addition to the regulation of Subchapter IV, which contains provisions on the revocation of the license and liquidation of the non-bank entity, including the liquidation process, its commencement and termination effects, the liquidation plan, the appointment of the liquidator and their duties, the working group, the cooperation with the Bank of Albania, and the reporting to the Credit Register.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([link](#))

Ndryshimet kryesore konsistojnë në:

- Ndryshimin e titullit të rregulores si vijon: "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka";
- Shtimin në objektin e rregulores "revokimin e licencës së subjekteve financiare jobanka për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë" dhe "likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare në bazë të licencës të subjektit financiar jobankë;
- Shtimin e ligjit nr.9901 datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, "Për falimentimin" si bazë juridike për këtë rregullore;
- Përkufizimi në rregullore i konceptit të "likuidim i portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare në bazë të licencës", duke e shpjeguar si "procesin e administrimit të portofolit të kredive, të subjektit financiar jobankë, të krijuar nga subjekti financiar jobankë, si rrjedhojë e veprimtarisë financiare të ushtruar sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë (më poshtë referuar si "likuidim")";
- Shtimin në rregullore të nënkreut IV i cili përmban dispozita mbi revokimin e licencës dhe likuidimit të subjektit jobankë, likuidimin, efektet e fillimit dhe përfundimin e tij, planin e likuidimit, emërimin e likuidatori dhe detyrat e tij, grupin e punës, bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë dhe raportimin në Regjistrin e Kredive.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania ([link](#))





Let's talk

PricewaterhouseCoopers Albania

Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1 Tirana, Albania

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al